



**Republika e Kosovës - Republic of Kosova**  
**Komuna – Municipality**  
**Hani Elezit**



**VENDIMET E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR MUAJIN MARS 2023**

Nr.	Emri i vendimit të Kryetarit – Shkurt 2023	Nr. Protokolit
1	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/1391/2023
2	Vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës	02/1713/2023
3	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/1715/2023
4	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/1750/2023
5	Vendim për caktimin e detyrave shtesë	02/1838/2023
6	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/1855/2023
7	Vendim për autorizimin e zyrtarëve për marrje të derivateve	02/1857/2023
8	Vendim mbi kompensimin e pagesës për mëditje jashtë vendit	02/1882/2023
9	Vendim mbi kompensimin e pagesës për mëditje jashtë vendit	02/1883/2023
10	Vendim mbi kompensimin e pagesës për mëditje jashtë vendit	02/1884/2023
11	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/1922/2023
12	Vendim për themelimin e komisionit	02/1948/2023
13	Vendim mbi kompensimin e pagesës për mëditje jashtë vendit	02/1950/2023
14	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/2060/2023
15	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/2061/2023
16	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/2202/2023
17	Vendim për miratimin e Iniciativës për Bashkëpunim Ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave	02/2251/2023
18	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/2333/2023
19	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/2356/2023
20	Vendim për formimin e komisionit për ndarjen e bursave	02/2372/2023
21	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/2406/2023
22	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/2449/2023
23	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës	02/2510/2023
24	Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e Planit për Transparencë 2023-2026 në KHE	02/2527/2023

25	Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e Strategjisë për Informim dhe Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të KHE	02/2528/2023
26	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për konsultime publike	02/2529/2023
27	Vendim për autorizimin për qasje në fjalëkalimin e administratorin të IT-së në KHE	02/2530/2023
28	Vendim për vëzhgimin e kamerave të sigurisë në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në KHE	02/2531/2023
29	Vendim për autorizimin për qasje në fjalëkalimin e administratorit të IT-së	02/2532/2023
30	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/2557/2023
31	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/2559/2023
32	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/2634/2023
33	Vendim për mbështetje financiare - Lehoni	02/2723/2023
34	Vendim për emërimin e menaxherit të kontratës dhe mbikqyrësit të drejtpërdrejtë	02/2806/2023
35	Vendim për mbështetje financiare – Lehoni	02/2810/2023
36	Vendim për mbështetje financiare	02/2821/2023



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02.Nr.1391/2023

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neni 2, në bazë të Rregullorës për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr 01.5349/2020, neni 21 pika 21.2.7 dhe kërkesës së palës, me nr.02/1391, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit merr këtë:

### V E N D I M PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

1. Merret vendim për mbështetje financiare për **Idajete Meliqi Thaçi** nga komuna e Hanit të Elezit për shkak të sëmundjes së saj, për mundësinë e ndonjë trajtimi, duke u bazuar në kushtet e vështira financiare, sipas dokumentacioneve të bashkangjitura në kërkesë.
2. **Shuma e mjeteve financiare për këtë mbështetje është 500 € ( Pesëqind euro)**, mjete këto që do të merren nga kategoria ekonomike subvencione – pagesë për përfitues individual.
3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe ekzekutohet nga drejtoria për buxhet dhe financa. Sipas rregulloreve të ndarjes së subvencioneve, pala është e obliguar për dëshminë e shpenzimeve për mbështetjen financiare komunës.
4. Me këtë vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 16.03.2023  
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit  
Municipality of Hani i Elezit

02.Nr. 1713 /2023

Duke u bazuar në Ligjin nr.03/L-040 Për Vetëqeverisen Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit lëshon këtë:

## VENDIM

(Për caktimin e Ushtruesit të detyrës)

I. Ziber Xhoni caktohet ushtrues detyre si drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë "Dardania" në Han të Elezit.

II. I lartpërmenduri këtë detyrë do ta ushtron nga periudha kohore prej datës 01.03.2023 deri më datën 31.05.2023 ku edhe ka të drejtën e nënshkrimit dhe të drejtën e pagës si Drejtor i Shkollës.

III. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe pasi të kryhet rekomandimi nga ana e Inspektoriatit të Arsimit për vlersimin e tij, ky vendim si Ushtrues Detyre pushohet.

III. Me këtë vendim njoftohet : Pala; Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport ; dhe arkivi i Komunës.

Data : 01.03.2023  
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



Ne bazë të neni 81 LPP-së nr.04/L-042 dhe Rregullorja nr.01/2022 për Prokurimin Publik neni 70 dhe neni 70.18 ZKA respektivisht ,Kryetari i Komunës merr këtë :  
Nr.02/ 1795

**V E N D I M**

**PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIKQYRËSIT TË DREJTPËRDREJTË**

- 1.Emërohet menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për kontratën” Mirembajtja e ndriçimit publik në zonën urbane dhe rurale-” me nr. të prokurimit: **KKHE-23-001-236**
- 2.Emërohet menaxher i kontratës z.**Kujtim Dernjani** – Shef i sektorit të Shërbimeve Publike.
- 3.Emërohet Mbikqyrës i drejtpërdrejtë z.**Arsim Dernjani**- Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Energjencave
- 4.Menaxher i kontratës dhe Mbikqyrësi i Drejtpërdrejt obligohen që të bëjnë administrimin, menaxhimin dhe implementin e kësaj kontrate konform **Ligjit për Prokurim Publik LPP-, Rregullorja nr.01/2022 për prokurim publik** – dhe sipas moduleve për menaxhim të kontratave.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.  
Ju dorëzohet :

- 1.Menaxherit të Kontrates
- 2.Mbikqyresit të drejtpërdrejt
- 3.Zyrës së Kryetarit
- 4.Zyrës së Prokurimit

Hani i Elezit  
Dt.28.02.2023

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi

*M. Ballazhi*





Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02.nr.1750/2023


Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neni 2, Vendimin për përkrahjen e lehonave 01 nr.469/2012 dhe ne bazë të kërkesës së palës, me nr. 02/1750, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit nxjerrë:

### V E N D I M PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

- 1. LEJOHEN** mjetet financiare për **Burbuqe Krasniqi**, qytetare e komunës së Hanit të Elezit me rastin e lindjes së fëmijës së saj, kërkesës dhe dokumentacioneve të kërkuara.
- 2. Shuma e mjeteve financiare është 100 € ( Njëqind euro )**, mjete këto që do të merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere - përfitues individual.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëher dhe me këtë vendim bëhet ekzekutimi i vendimit të Kuvendit të Komunës për përkrahjen e lehonave në komunën e Hanit të Elezit.
4. Me këtë vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 09.03.2023  
Hani i Elezit

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi





Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit  
Municipality of Hani i Elezit

02N/1838/2023

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës nr. 03/L-040 neni 13 mbi aktet e kryetarit të Komunës si dhe në bazë të nevojës për ngritjen e efikasitetit në administratën komunale , Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M (mbi caktimin e detyrave shtesë)

- 1 .Nëpunësi **Remzi Bushi** i radhitur në vendin e punës si Zyrtar i Mirëmbajtjes së operatit kadastral pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit caktohet të kryej edhe detyra shtesë si **Zyrtar i TI-së**.
2. I lartëpërmenduri përveq punës primare si **Zyrtar i Mirëmbajtjes së operatit kadastral** do të angazhohet edhe me detyra shtesë si **zyrtar i TI-së**.
- 3.Me këtë vendim shfuqizohet vendimi nr 02/521/2010 i datës 05.10.2010 “mbi pagesën e shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesionistëve deficitar” për nëpunësin **Bashkim Sopa**
4. Me këtë vendim njoftohen :Nëpunësi , Personeli dhe Arkivi i Komunës

### A r s y e t i m

Duke pasur parasysh se Komuna e Hanit të Elezit ka një numër të vogël të stafit civil, në pamundësi për të rekrutuar nëpunës të ri që do të mirreshin ekskluzivisht me detyrat e lartëpërmendura, gjithashtu bazuar në domosdoshmërinë e ekzistimit të kësaj pozite, sfidat në rekrutimin nga jashtë për shkak të kushteve të tregut në mënyrë që të ketë efikasitet në administratë komunale, Kryetari i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Data : 01.03.2023  
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës  
**Mehmet Ballazhi**

*Mehmet Ballazhi*



Republika e Kosovës - Republic of Kosova

Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



Ne bazë të neni 81 LPP-së nr.04/L-042 dhe Rregullorja nr.01/2022 për Prokurimin Publik neni 70 dhe neni 70.18 ZKA respektivisht, Kryetari i Komunës merr këtë :  
Nr.02/ 1855 /2023

## V E N D I M

### PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIKQYRËSIT TË DREJTPËRDREJTË

1. Emërohet menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për kontratën "Zhbllokimi i gypave të kanalizimit fekal dhe atmosferik në zonën urbane dhe zonë rurale të Komunës së Hani të Elezit" me nr. të prokurimit: KKHE-23-003-236

2. Emërohet menaxher i kontratës z. **Kujtim Dernjani** – Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike.

3. Emërohet Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë z. **Arsim Dernjani**- Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Energjencave.

4. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë obligohen që të bëjnë administrimin, menaxhimin dhe implementimin e kësaj kontrate konform Ligjit për Prokurim Publik LPP-, Rregullorja nr.01/2022 për prokurim publik – dhe sipas moduleve për menaxhim të kontratave.

5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ju dorëzohet :

1. Menaxherit të Kontrates

2. Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë

3. Zyrës së Kryetarit

4. Zyrës së Prokurimit

Hani i Elezit  
Dt.01.03.2023

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi







REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN  
KOMUNA HANI I ELEZIT



02.nr/1857 2023

Ne bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës Nr.03/L-040, në bazë të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, numër 01.7703/2018, neni 11, Kryetari i Komunës nxjerrë:

## V E N D I M

Për autorizimin e zyrtarëve për marrje të derivateve

1. **Zyrtari Shefket Beqa** autorizohet për marrjen e derivateve për automjetet zyrtare komunale brenda orarit të rregullt të punës, pranë Kabinetit të Kryetarit.
2. **Zyrtari Sadik Brava dhe Nexhmedin Bushi** autorizohen për marrjen e derivateve për automjetet zyrtare komunale brenda orarit të rregullt të punës, pranë Drejtorisë së Administratës.
3. **Zyrtari Bedri Daci dhe Xhelal Meliçi** autorizohen për marrjen e derivateve për automjetet zyrtare të QKMF-së brenda orarit të rregullt të punës, pranë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
4. **Zyrtari Nexhmedin Fida dhe Sali Curri** autorizohen për marrjen e derivateve për automjetet zyrtare të zjarrëfiksëve brenda orarit të rregullt të punës, pranë Drejtorisë për Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
5. Ky vendim bëhet për shkak të marrjes së masave për integritetin institucional i cili është obligim që të zbatohet për kontrollin e shtuar të automjetve.
6. Me këtë vendim njoftohen: Zyrtarët e autorizuar, Drejtoritë Përkatëse, Kompania e autorizuar e derivateve dhe Arkivi i Komunës.

01.03.2023  
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA  
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN  
KOMUNA HANI I ELEZIT



02/1882

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040, gjithashtu bazuar në vendimin nr 30/2018 të datës 19.06.2018 për aprovimin e tarifave për udhëtimet jashtë vendit dhe rregulloren mbi kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe pagesën e mëditjeve neni 3,4 dhe 5 mirret ky vendim

VENDIM  
MBI KOMPENZIMIN E PAGESËS PËR MEDITJEVE JASHTË VENDIT NË TIRANË

1. Me këtë vendim lejohet kompensimi i pagesës së mëditjes të udhëtimit zyrtar në Tiranë për nëpunëson Hisni Luri.
2. Ky udhëtim zyrtar do të bëhet me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë e organizuar nga Caritas me temë Hyrje në ndryshimet Klimatike.
3. Shuma e kompensimit përkatësisht mëditjes për 2 ditë (26 €) të qëndrimit në Tiranë është 52.00 €
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Me këtë vendim njoftohen :

- z. Hisni Luri
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Zyra e personelit

Data 23.02.2023

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi

*M Ballazhi*



**TRAJNIM I PROFESORËVE TË SHKOLLAVE TË MESME PËR NDRYSHIMET  
KLIMATIKE – MODULI I “HYRJE NË NDRYSHIMET KLIMATIKE”**

**AGJENDA**

**DATA 11-12 SHKURT, 2023  
VENDI: HOTEL “DORO CITY”, TIRANË**

<b>Koha</b>	<b>Aktiviteti</b>
<b>Dita e parë 11.02.2023</b>	<b>Vizitë në Institutin Edukativ Mjedbhor “Muzeu i Shkencave të Natyrës”- Sabiha Kasimati</b>
<b>07:45 - 12:00</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nisja nga Prishtina - Stacioni i autobusëve</li> </ul>
<b>12:00 - 12:30</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arritja në Tiranë dhe vendosja në hotel</li> </ul>
<b>12:30 – 13:30</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dreka</li> </ul>
<b>14:00 – 16:30</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vizitë në Muzeu e Shkencave të Natyrës “Sabiha Kasimati” Ciceroni dhe profesorët e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”</li> </ul>
<b>16:30 – 19:00</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kohë e lirë</li> </ul>
<b>19:00 - 20:00</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Darka</li> </ul>
<b>Dita e dytë 12.02.2023</b>	<b>Moduli I “Hyrje në Ndryshime Klimatike”</b>
<b>08:00 - 08:50</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mëngjesi</li> </ul>
<b>08:50 - 09:00</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hapja e trajnimit - Moduli I “Hyrje në Ndryshime Klimatike” Bardh Xërxa - Projekt menaxher - Caritasi Zviceran-YENI</li> </ul>
<b>09:00 - 10:30</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnim: Moduli I (pjesa e parë) Profesor Agim Gashi – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore - Departamenti i Biologjisë</li> </ul>
<b>10:30 - 10:45</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pauzë për kafe</li> </ul>
<b>10:45 - 12:00</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnim: Vazhdim i pjesës së parë</li> </ul>
<b>12:00 - 13:00</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dreka</li> </ul>
<b>13:00 - 14:30</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnim: Moduli I (pjesa e dytë) Profesor Halil Ibrahimimi – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore - Departamenti i Biologjisë</li> </ul>
<b>14:30 - 14:45</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pauzë për kafe</li> </ul>
<b>14:45 - 15:30</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trajnim: Vazhdim i pjesës së dytë</li> </ul>
<b>16:00 - 20:00</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Arritja në Prishtinë</li> </ul>

From: **Bardh Xërxa** <[bxerxa@caritas.ch](mailto:bxerxa@caritas.ch)>

Date: Fri, 3 Feb 2023 at 13:54

Subject: Caritasi Zviceran - YENI projekti - Ftesë për trajnim - "Hyrje në Ndryshimet Klimatike"!

To: [lanibushi@gmail.com](mailto:lanibushi@gmail.com) <[lanibushi@gmail.com](mailto:lanibushi@gmail.com)>, [hisni.luri@rks-gov.net](mailto:hisni.luri@rks-gov.net) <[hisni.luri@rks-gov.net](mailto:hisni.luri@rks-gov.net)>

Cc: Besarta Hajrizi <[bhajrizi@caritas.ch](mailto:bhajrizi@caritas.ch)>, Fjollë Caka Farizi <[fcaka@caritas.ch](mailto:fcaka@caritas.ch)>

I nderuar Orhan

Caritasi Zviceran në kuadër të projektit Ndikimi i Rinisë në Mjedis (YENI), ka nderin t'iu ftojë të merrni pjesë në trajnimin e parë - Moduli I – "Hyrje në Ndryshimet Klimatike" për profesorët e lëndëve të biologjisë dhe ekologjisë të SHML të Kosovës.

Sic biseduam ne telefon pervec juve dhe Hisniut ju lutem kontaktoni edhe me nje zyrtar mjedisor ne Komunen tuaj per marrje pjese ne trajnim.

Trajnimi do të mbahet nga profesorët e Universitetit të Prishtinës, respektivisht të Fakultetit të Skencave Matematike Natyrore - Departamentit të Biologjisë.

Ky trajnim dy ditor do të mbahet më datat **11 dhe 12 shkurt 2023**, në "Hotel Doro City" **Tiranë, Shqipëri**.

Të gjithë pjesëmarrësit do të mblidhen në **stacionin e autobusëve në Prishtinë**, prej nga do të bëhet nisja e organizuar me autobus më **11 shkurt 2023**, ora **07:45** e mëngjesit. Bashkangjitur me këtë e-mail gjeni draft agjendën dhe detajet tjera të ngjarjes për shqyrtimin tuaj të mëtejshëm.

Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj duke iu përgjigjur këtij emaili deri në datën **07 shkurt 2023**.

Njoftoheni që shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit (fjetja dhe ushqimi) në Tiranë janë të mbuluara nga projekti YENI i Caritasit Zviceran.



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA

MUNICIPALITY OF ELEZ HAN

KOMUNA HANI I ELEZIT



02/1883

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040, gjithashtu bazuar në vendimin nr 30/2018 të datës 19.06.2018 për aprovimin e tarifave për udhëtimet jashtë vendit dhe rregulloren mbi kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe pagesën e mëditjeve neni 3,4 dhe 5 mirret ky vendim

### VENDIM

#### MBI KOMPENZIMIN E PAGESËS PËR MEDITJEVE JASHTË VENDIT NË TIRANË

1. Me këtë vendim lejohet kompensimi i pagesës së mëditjes të udhëtimit zyrtar në Tiranë për nëpunësen Sevime Bajrami.
2. Ky udhëtim zyrtar do të bëhet me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë e organizuar nga Caritas me temë Hyrje në ndryshimet Klimatike.
3. Shuma e kompensimit përkatësisht mëditjes për 2 ditë (26 €) të qëndrimit në Tiranë është 52.00 €
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Me këtë vendim njoftohen :

- znj.Sevime Bajrami
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Zyra e personelit

Data 23.02.2023





REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA

MUNICIPALITY OF ELEZ HAN

KOMUNA HANI I ELEZIT



02/1884

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040, gjithashtu bazuar në vendimin nr 30/2018 të datës 19.06.2018 për aprovimin e tarifave për udhëtimet jashtë vendit dhe rregulloren mbi kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe pagesën e mëditjeve neni 3,4 dhe 5 mirret ky vendim

### VENDIM

#### MBI KOMPENZIMIN E PAGESËS PËR MEDITJEVE JASHTË VENDIT NË TIRANË

1. Me këtë vendim lejohet kompensimi i pagesës së mëditjes të udhëtimit zyrtar në Tiranë për nëpunësen Fatbardha Bushi.
2. Ky udhëtim zyrtar do të bëhet me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë e organizuar nga Caritas me temë Hyrje në ndryshimet Klimatike.
3. Shuma e kompensimit përkatësisht mëditjes për 2 ditë (26 €) të qëndrimit në Tiranë është 52.00 €
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Me këtë vendim njoftohen :

- znj.Fatbardha Bushi
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Zyra e personelit

Data 23.02.2023





Republika e Kosovës - Republic of Kosova

Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



Ne bazë të neni 81 LPP-së nr.04/L-042 dhe Rregullorja nr.01/2022 për Prokurimin Publik neni 70 dhe neni 70.18 ZKA respektivisht „Kryetari i Komunës merr këtë :  
Nr.02/ 1922 2023

## V E N D I M

### PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIKQYRËSIT TË DREJTPËRDREJTË

1.Emërohet menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për kontratën” **Shërbime konsulte -Angazhimi i një (1) psikolog-e për nevoja të QPS-së”** me nr. të prokurimit: **KKHE-KKHE-23-007-2-3-6**

2.Emërohet menaxher i kontrates z.**Bekim Vlasi** – Zyrtar në Qendrën për Punë Sociale.

3.Emërohet Mbikqyrës i drejtpërdrejtë z.**Kimete Kuka -Hasallari-** Drejtoresh e Shëndetsisë dhe Mirëqenjes Sociale.

4.Menaxher i kontratës dhe Mbikqyrësi i Drejtpërdrejt obligohen që të bëjnë administrimin, menaxhimin dhe implementin e kësaj kontrate konform **Ligjit për Prokurim Publik LPP-**, **Rregullorja nr.01/2022 për prokurim publik** – dhe sipas moduleve për menaxhim të kontratave.

5.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ju dorezohet :

1.Menaxherit të Kontrates

2.Mbikqyrësit të drejtpërdrejt

3.Zyrës së Kryetarit

4.Zyrës së Prokurimit

Hani i Elezit  
Dt.03.03.2023

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi





02/Nr. 1948 /2023  
07.03.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 68 paragrafi 7 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 7 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Kryetari i Komunës, nxjerrë :

## V E N D I M

1. Themelohet komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë aplikuar në vendin e punës: Mësimdhënës/e i lëndës Matematikë në SHFMU” Veli Ballazhi”-fshati Gorancë, Hani Elezit.

2. Komisioni ka këtë përbërje:

- Faruk Berisha (drejtor i shkollës), kryesuse i komisionit
- Sear Dernjani (Shef i arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm DKA), anëtar i komisionit
- Irfan Qajani (pedagog i shkollës)-anëtarë i komisionit
- Imrane Curri (Mësimdhënëse e matematikës)- anëtare e komisionit
- Ajete Berisha-Duraj (Udhëheqese personeli), anëtare e komisionit

3. Komisioni ka për detyrë të i testoj dhe intervistojë kandidatët me shkrim dhe me gojë dhe të përzgjedhë kandidatin më të mirë.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- Zyra e personelit dhe arkivi



Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi





Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit  
Municipality of Hani i Elezit

02Nr. 1950 /23

Bazuar në vendimin nr 30/2018 të datës 19.06.2018 për aprovimin e tarifave për udhëtimet jashtë vendit dhe Rregulloren mbi kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe pagesën e mëditjeve neni 3, 4 dhe 5 mirret ky vendim:

### V E N D I M

#### MBI KOMPENZIMIN E PAGESËS PËR MËDITJE JASHTË VENDIT NË SHQIPËRI

1. Me këtë vendim lejohet kompensimi i pagesës së mëditjes të udhëtimit zyrtar në Shqipëri për z.Shefket Beqa
2. Ky udhëtim zyrtar do të bëhet me qëllim të shoqërimit të Kryetarit të Komunës në pjesëmarrjen në “Besëlidhjen e Lezhës” e organizuar nga “Bashkia e Lezhës
3. Shuma e kompensimit përkatësisht mëditjes për dy (2) ditë të qëndrimit në Shqipëri , është **52.00 €**.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Me këtë vendim njoftohen:

- z. Shefket Beqa
- Drejtoria për buxhet dhe financa
- Zyra e personelit dhe arkivi.

Data: 07.03.2023

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



Ne bazë të neni 81 LPP-së nr.04/L-042 dhe Rregullorja nr.01/2022 per Prokurimin Publik neni 70 dhe neni 70.18 ZKA respektivisht ,Kryetari i Komunës merr kete :  
Nr.02/ 2060 /2023

## V E N D I M PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIQYRËSIT TË DREJTPËRDREJTË

1.Emërohet menaxheri i kontratës dhe Mbiqyrësi i drejtpërdrejtë për kontratën” **Furnizim dhe montim me material sanitari dhe elektrikë ne objekin e QKMF-së.**” me nr. të prokurimit:  
**KKHE-23-008-1-36**

2.Emërohet menaxher i kontrates z.Naser Laçi – Shef i sektorit të Shëndetsisë.

3.Emërohet Mbiqyrës i drejtpërdrejtë z.Kimete Kuka-Hasallari- Drejtoresh e Shëndetsisë dhe Mirëqenjes Sociale.

4.Menaxher i kontratës dhe Mbiqyrësi i Drejtpërdrejt obligohen qe te bejn administrimin, menaxhimin dhe implementin e kesaj kontrate konform Ligjit per Prokurim Publik LPP-, Rregullorja nr.01/2022 per prokurim publik – dhe sipas moduleve per manaxhim te kontratave.

5.Ky vendim hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit.

Ju dorezohet :

- 1.Menaxherit të Kontrates
- 2.Mbiqyresit të drejtpërdrejt
- 3.Zyrës së Kryetarit
- 4.Zyrës së Prokurimit

Hani i Elezit  
Dt.09.03.2023

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



Ne bazë të neni 81 LPP-së nr.04/L-042 dhe Rregullorja nr.01/2022 për Prokurimin Publik neni 70 dhe neni 70.18 ZKA respektivisht ,Kryetari i Komunës merr këtë :  
Nr.02/ 2061 /2023

## V E N D I M

### PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS DHE MBIKQYRËSIT TË DREJTPËRDREJTË

1.Emërohet menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për kontratën” Mirëmbajtja e shportave të mbeturinave, ulëseve të parqeve,ngjyrosjen,rrethojat e hekurta,shenjave të dëmtuara,salldimin e mbrojtseve.” me nr. të prokurimit: KKHE-23-006-236

2.Emërohet menaxher i kontrates z.Amir Berisha – Zyrtar i Sherbimeve Publike.

3.Emërohet Mbikqyrës i drejtpërdrejtë z.Arsim Dernjani- Drejtor i Sherbimeve Publike

4.Menaxher i kontratës dhe Mbikqyrësi i Drejtpërdrejt obligohen që të bëjnë administrimin, menaxhimin dhe implementin e kësaj kontrate konform Ligjit për Prokurim Publik LPP-, Rregullorja nr.01/2022 për prokurim publik – dhe sipas moduleve për menaxhim të kontratave.

5.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ju dorëzohet :

- 1.Menaxherit të Kontrates
- 2.Mbikqyresit të drejtpërdrejt
- 3.Zyrës së Kryetarit
- 4.Zyrës së Prokurimit

Hani i Elezit  
Dt.09.03.2023

Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02.nr.2202/2023

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neni 2, Vendimin për përkrahjen e lehonave 01 nr.469/2012 dhe ne bazë të kërkesës së palës, me nr. 02/2202, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit nxjerrë:

### V E N D I M PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

- 1. LEJOHEN** mjetet financiare për **Arlinda Rexhaj Qajani**, qytetare e komunës së Hanit të Elezit me rastin e lindjes së fëmijës së saj, kërkesës dhe dokumentacioneve të kërkuara.
- 2. Shuma e mjeteve financiare është 100 € ( Njëqind euro )**, mjete këto që do të merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere - përfitues individual.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëher dhe me këtë vendim bëhet ekzekutimi i vendimit të Kuvendit të Komunës për përkrahjen e lehonave në komunën e Hanit të Elezit.
4. Me këtë vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 16.03.2023  
Hani i Elezit





*Republika e Kosovës - Republic of Kosova*  
*Komuna – Municipality*  
*Hani i Elezit*



Në bazë të nenit 12, nenit 28, nenit 29, nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit propozon:

## VENDIM

1. Për miratimin e Iniciativës për Bashkëpunim Ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.
2. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave:
  - 2.1. Komuna e Gjilanit;
  - 2.2. Komuna e Ferizajt;
  - 2.3. Komuna e Kamenicës;
  - 2.4. Komuna e Vitisë;
  - 2.5. Komuna e Kaçanikut;
  - 2.6. Komuna e Hanit të Elezit;
  - 2.7. Komuna e Shtëmës;
  - 2.8. Komuna e Shtërpcës;
  - 2.9. Komuna e Parteshit;
  - 2.10 Komuna e Kllkotit
  - 2.11 Komuna e Ranillugut
  - 2.12 Komuna e Novobërdës
3. Kryetari i Komunës dhe Ekipi Ndërkomunal (i themeluar nga Kryetari, datë: 17.08.2022 me nr. protokollit **02.nr.6634/2022**) janë të autorizuar të iniciojnë dialogun dhe të punojnë së bashku në hartimin e Planit të Integruar Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave, të identifikojnë implikimet e mundshme financiare duke përfshirë burimet e financimit për zbatimin e duhur të Planit. Kryetari i Komunës dhe ekipi ekzistues ndër-komunal mund të identifikojnë gjithashtu implikime të tjera të mundshme në lidhje me bashkëpunimin ndërkomunal në sektorin e menaxhimit të integruar të mbeturinave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen e komunës së Hanit të Elezit.

02/nr. 2251 /2023  
Komuna e Hanit të Elezit





Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02.nr.2333/2023

